

VENDIM
Nr. 879, datë 30.10.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE,
PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/2 shtohet emërtesa “Agjencia e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog”;

b) Pas pikës 3/1 shtohet pika 3/2, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“3/2. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Shkollën e Magjistraturës të jenë sipas lidhjes nr. 3/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Pika 4/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

c) “4/2. Në Kryeministri, pozicionet “Drejtore të Departamentit të Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit”, “Drejtore të Departamentit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj” dhe “Drejtore të Departamentit të Jetësimit të Prioriteve”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj; pozicionet “Drejtore njësie, jurist, koordinator dhe inspektor në Departamentin e Legjislacionit dhe Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit”, “Drejtore njësie, drejtore drejtorie dhe koordinator në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj” dhe pozicionet “Koordinator në Departamentin e Jetësimit të Prioriteteve”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

ç) Në pikën 5 shtohet një paragraf, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“stenograf, regjistruar audio, në Kryeministri.”.

d) Në pikën 6 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Paga, për pozicionin zëvendës-drejtore të Kabinetit të Kryeministrit, është 141 500 lekë.”.

dh) Të gjitha emërtesat që i përkasin Shkollës së Magjistraturës, në lidhjen nr. 7, të cilat përmenden në pikën 11, shfuqizohen.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për:

- shkronjat “a” e “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve të secilit institucion, në detyrë dhe, për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për këto institucione për këtë vit;

- të gjitha shkronjat e tjera, të fillojnë nga data 1 janar 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr. 3/3

**Kategoritë e pagave të pozicioneve
të punës në Shkollën e Magjistraturës**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimiit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit
Drejtor drejtorie Këshilltar akademik	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Redaktor shkencor Sekretar shkencor	III-b	1 ose 2
Specialist Bibliograf. Redaktor letrar.	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3